



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

OPINION MBI KANDIDATIN Znj. FATJONA MEMÇAJ

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53/2, 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në nenin 5 të ligjit nr.113/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST”, në datën 24.02.2020 me vendimin nr.74, ka hapur garën për të shprehur interresin për t’u komanduar si **Prokuror ndërlidhës pranë Eurojust** nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë paraqitur kërkesë 2 (dy) prokurorë.

Në datë 11.03.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurores Fatjona Memçaj, e cili aktualisht ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e Prokurorit ndërlidhës pranë Eurojust.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 54/4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokuroris ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar cënimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

Prokurorja Fatjona Memçaj ushtron funksionin e magjistratit që prej vitit 2002, ku është emëruar prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku dhe ka vazhduar detyrën deri në vitin 2007. Më pas ka patur një eksperiencë Drejtuese në Institucionin e Presidentit për tu rikthyer në sistemin e prokurorisë, fillimisht në Prokurori të Përgjithshme si Drejtor Kabineti e më pas në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (ku ushtron aktualisht detyrën). Nga dosja personale rezulton se ka një eksperiencë profesionale në punë për afro 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet, nga të cilat 13 vjet si Magjistrat në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe atë të Apelit Tiranë, duke përmbushur kushtet e vjetërsisë në punë. Znj. Memçaj nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është dhe as ka qenë më parë e komanduar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Gjithashtu Znj. Memçaj ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me Vendim të formës së prerë.

Për sa i përket eksperiencave në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë ajo ka eksperiencë në mbikqyrjen e Drejtorisë së marrëdhënieve me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme.

Pë sa i përket njohjes së Gjuhës Angleze, Znj. Memçaj zotëron çertifikatë IELTS nga British Council si dhe ka kryer studime pasuniversitare në Universitete të Mbretërisë së Bashkuar.

Përveç sa më sipër Znj. Memçaj ka një karrierë të gjatë akademike, ka marrë pjesë në shumë trajnime brenda dhe jashtë vendit si dhe është autore publikimesh.

➤ Në këto kushte për këtë prokurore nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesi të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë ku është i caktuar, rezultojnë se:

➤ Nga kthim-përgjigja me shkresën nr. 285/1, datë 03.04.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë rezultojnë se për shkak të numrit të reduktuar të prokurorëve ngarkesa në këtë prokurori ka qenë e konsiderueshme, por nga ana tjetër, Drejtuesi vlerëson aftësitë dhe përgatitjen e znj. Memçaj duke dhënë mbështetje për kandidimin e saj si prokurore ndërlidhëse pranë EUROJUST.

Në këto kushte, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i znj. Fatjona Memçaj pranë EUROJUST nuk passjell cenim të interesave të larta të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nuk cenohet funksionaliteti i saj.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

Vijimin e procedurave të komandimit për kandidatin prokuror Znj.Fatjona Memçaj.

KOMISIONI PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS

KRYETAR

SANDËR BECI

ANËTAR

BUJAR SHESHI

ANËTAR

VATË STAKA